



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	226
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	03.06.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/226/2024
Datë: 03/06/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 11, paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 18 i Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 03 qershor 2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet procesverbali i takimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i mbajtur më 26 mars 2024;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA REPUBLIKAKADÉMIA E DREJTËSISË AKADEMIA E DREJTËSISË OF KOSOVA AKADEMIA PRÁVDA / ACADEMY OF JUSTICE	
Njesia. Org. Org. Jedis. Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.
Nr. Faqeve Be. Stranica No. Pages	Datum Datum Date
01	277
01	05.06.2024
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademia Právdë/Academy of Justice

Nr. 01/277/2024
Datë: 03/06/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, nenit 11, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 e Rregullores Nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për punën e Këshillit Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 03 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Kërkesa buxhetore 2025-2027 e Akademisë së Drejtësisë;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së
- U.D. Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të AD-së



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	278
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	03.06.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademiya Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/278/2024
Datë: 03/06/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05-L/095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.10 i Rregullores Nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.02/2017 për punën e Këshillit Drejtues dhe nenit 20, paragrafi 2 i Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar, në mbledhjen e mbajtur më dt. 03 qershor 2024, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave të testit përfundimtar në PTF në mënyrë unanime merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** ankesa e prokurores znj. Iliriana Haziri Kryeziu (prokurore e sapoemëruar, gjenerata e X) me Nr. 220 e dt. 10 maj 2024, rreth vlerësimit të testit përfundimtar për prokurorët e sapoemëruar gjenerata X, i organizuar nga Akademia e Drejtësisë gjatë datave 24-26 prill 2024.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Akademia e Drejtësisë gjatë datave 24-26 prill 2024 ka realizuar testin përfundimtar për prokurorët e sapoemëruar (gjenerata e X), në 5 module trajnuese, konform Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar. Me këtë rast, prokurorja znj. Iliriana Haziri Kryeziu, pas publikimit të rezultateve finale, ka parashtruar ankesë ndaj rezultateve të testit përfundimtar, në modulet e Kodit Penal, Kodit të procedurës penale, Rendit Juridik dhe Shkathtësive personale dhe ndërdisiplinare.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave të testit përfundimtar në PTF, i formuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më 21 maj 2024 ka shqyrtuar ankesën e prokurores në fjalë duke rishikuar komplet testin në modulet në të cilat prokurorja ka shprehur pakënaqësi në vlerësim.

Pas rishikimit të testit dhe vlerësimit të të gjithë anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e ankesave, Komisioni në mënyrë unanime ka vlerësuar ankesën si të pabazuar, duke e mbështetur vlerësimin e Komisionit paraprak të cilët kanë përpiluar pyetjet e testit dhe kanë bërë vlerësimin e kandidatëve, duke konsideruar se vlerësimi ka qenë korrekt, profesional dhe pa gabime teknike.

Andaj, Këshilli Drejtues duke aprovuar rekomandimet e Komisionit, në mënyrë unanime miraton rekomandimin si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vaton Durguti

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- znj. Iliriana Haziri Kryeziu – Prokurore e sapoemëruar (gjenerata X)
- Udhëheqëses së Divizionit për Trajnimin Fillestar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të shtetit
- Arkivit të AD-së



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	279
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	09	Data Datum Date	05.06.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/279/2024

Datë: 03/06/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, dhe nenit 25, paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 i Rregullores nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 02/207 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, nenit 14 të Rregullores nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë në mbledhjen e mbajtur më datë 03 qershor 2024 merr këtë:

V E N D I M

- I.** Miratohet propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 127/2024 i dt. 30 maj 2024 për mentorët për Gjyqtarët me mandat fillestar (gjenerata XI), të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën Komerciale dhe Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, në pjesën praktike.
- II.** Kandidatët e propozuar për mentorë në Dhomat e shkallës së parë në Gjyqtarin me mandat fillestar në Gjykatën Komerciale janë si në vijim:
 1. Hasan Kryeziu, Gjyqtar në Dhomat e shkallës së parë në Gjykatën Komerciale;
 2. Fisnik Nuli, Gjyqtar në Dhomat e shkallës së parë në Gjykatën Komerciale;
- III.** Kandidatët e propozuar për mentorë në Dhomat e shkallës së parë në Gjyqtarin me mandat fillestar në Gjykatën Komerciale janë si në vijim:
 1. Sabit Sadikaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë penale;
 2. Donikë Shala, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë penale;

3. Eroll Gashi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë penale;
4. Edita Çanta, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë penale;
5. Përparim Zeka, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë civile;
6. Ilire Vitija, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë civile;
7. Nexhat Qallapeku, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë civile;
8. Valentina Sopjani, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë, propozohet për mentor në lëminë penale;

IV. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Gjilan janë si në vijim:

1. Rilind Sermaxhaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Liridona Haziri Mustafa, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Gjilan, propozohet për mentor në lëminë civile;

V. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prizren janë si në vijim:

1. Vjollca Buzhala, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Taulant Rexhëbeqaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren, propozohet për mentor në lëminë civile.

VI. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Gjakovë janë si në vijim:

1. Ilir Rashkaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjakovë, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Mizahir Shabani, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, propozohet për mentor në lëminë penale;
3. Durim Balaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjakovë, propozohet për mentor në lëminë civile;
4. Betim Behluli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, propozohet për mentor në lëminë civile;

VII. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Pejë janë si në vijim:

1. Leon Përlaska, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Musë Povataj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë, propozohet për mentor në lëminë penale;
3. Migjen Kastrati, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë, propozohet për mentor në lëminë civile;
4. Besnik Shala, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Pejë, propozohet për mentor në lëminë civile

VIII. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Ferizaj janë si në vijim:

1. Imri Sejda, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Mimoza Shabani, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj, propozohet për mentor në lëminë penale;
3. Zajrete Muhaxheri, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik, propozohet për mentor në lëminë penale;
4. Faton Ajvazi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj, propozohet për mentor në lëminë civile;
5. Kreshnike Zymberi Beqiri, Gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj, propozohet për mentor në lëminë civile;
6. Burhan Berisha, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik, propozohet për mentor në lëminë civile.

IX. Kandidatët e propozuar për mentorë në lëmine penale dhe civile për Gjyqtarët me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Mitrovicë janë si në vijim:

1. Mentor Hajraj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë, propozohet për mentor në lëminë penale;
2. Avdullah Mecinaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë – Dega Skenderaj, propozohet për mentor në lëminë civile.

X. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Akademia e Drejtësisë më dt. 30 maj 2024, ka pranuar kërkesën nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me nr. 127/2024 me nr. protokoli 01/465 me propozimet për miratim të mentorëve për Gjyqtarët me mandat fillestar të cilët ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën Komerciale dhe Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, në pjesën praktike.

Këshilli Drejtues në takimin e mbajtur më 03 qershor 2024, pas shqyrtimit të kërkesës së KGJK-së lidhur me të njëjtën vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Mentorëve të angazhuar
Udhëheqëses së Divizionit për Trajnimin Fillestar
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë